

NJË PËRGJIGJE PËR TË SQARUAR

- 1) Shërbimi televiziv realizuar kohët e fundit nga një gazetar i një OJF, e cila hiqet si mbrojtëse e lirisë së shtypit – dhe transmetuar nga një televizion i Tiranës – **para se të saktësojë përgjegjësitë e mundshme**, përdor në mënyrë fyese dhe në kundërshtim me çfarëdolloj rregulli profesional emrin e një Enti (“Kongregacioni i Bijve të Zojës së Papërlyer”) për të ironizuar mbi ndershmërinë e rregulltarëve, pjesëtarë të saj dhe që janë operatorë solidariteti në njëzet Vende të botës, sidomos mes popujve më të varfër.
- 2) Zhurma e scoop-it mediatic lidhur me spitalin e dëshiruar nga Nënë Tereza, duket si zbulimi i Amerikës. Që ka një vonesë në përfundimin e tij kjo është diçka e njohur. **Por nuk thuhet asgjë për arsyet e kësaj vonese** (mjaft të mendosh se çfarë ka ndodhur në Shqipëri e përreth viteve 1997 deri në vitin 2000!) dhe po ashtu asgjë nuk thuhet për atë që **funksionon tashmë**: një Poliambulancë e mirënjohur, Qendra e Rehabilitimit Neuro Muskular, Qendra Stomatologjike dhe një Shërbim diagnostikimi kardiologjik që është në aktivizim.
- 3) Emisioni **jep informacione krejtësisht të gabuara mbi financime të supozuara shumë të mëdha** të ardhura nga Qeveria Shqiptare apo Qeveria Italiane: e vërteta është se Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë kurrë nuk i kanë ardhur para nga këto burime. Po të ishte kështu spitali tashmë do të kishte përfunduar. Përkundrazi, shumica të mëdha janë mbledhur drejtpërdrejt nga Fondacioni, dhe sidomos bëhet fjalë për një dhuratë të Kishës Katolike italiane. Këto shumica janë përdorur – dhe gazetari duket se as që e ka vërtetuar këtë – për të rikonstruktuar 5.000 m² që ekzistonin e për të ndërtuar edhe 12.000 m² të reja.
- 4) Gjithashtu thuhet se trualli i dhënë nga Shteti shqiptar është i caktuar vetëm për spitalin: në të kundërt, duhet saktësuar se marrëveshja parashikonte një **qëllim akademik – formues të projektit spitalor**. Për këtë arsye u themelua Universiteti. Duhet sqaruar më pas se gjysma tjetër e truallit i referohet një sipërfaqe që Shteti e ka vënë në dispozicioni të Kishës Katolike shqiptare pikërisht për realizimin e një Universiteti dhe, Fondacioni ZKM është duke e realizuar këtë projekt. Edhe **ky truall është transferuar ligjërisht** përmes një vendimi të Këshillit të Ministrave dhe në mënyrë të rregullt **i regjistruar në zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme**. Prandaj nuk bëhet fjalë për një truall të zaptuar apo zënë me ndërtime pa leje, ashtu sikurse pretendohet në emision. Ndërtimi i ndërtesës aktuale të Universitetit ka **leje të rregullt nga autoritetet kompetente**. Shtrembërimi flagrant i fakteve nga gazetari bëhet i qartë: për të mashtruar opinionin dhe aspak për ta informuar atë.
- 5) Universiteti është realizuar nga Fondacioni ZKM dhe është miratuar nga Qeveria në vitin 2004. Bëhet fjalë për një iniciativë të shkëlqyer nëpërmjet së cilës fitohet diploma e vlefshme edhe në BE, e për të cilën bashkëpunojnë përveç shqiptarëve, edhe 500 pedagogë italianë. Kush punon atje ose është vullnetar (si rregulltarët e Kongregatës Bijtë e Zojës së Papërlyer) ose kanë një marrëdhënie të rregullt punësimi. **Ky Universitet, si dhe çdo iniciativë tjetër e jona, nuk është pronë e asnjë individi e nuk ka asnjë bashkëpronar, kushdo qoftë ky.**

Të thuash pastaj, se Universiteti përfaqëson për Fondacionin një “business” të pastër është jo korrekte: Fondacioni është një ent që nuk ka qëllime fitimi dhe prandaj investon gjithçka për zhvillimin e veprimtarisë. Asgjë nuk mbahet në favor të Kongregacionit që ka themeluar Fondacionin dhe, përfaqësuesit e tij kanë punuar gjithmonë falas.

- 6) Pasi ka investuar në Shqipëri 20 milionë euro, Fondacioni **ka punësuar më tepër se 250 qytetarë shqiptarë**. Dhe e gjithë kjo do të thotë diçka.
- 7) Fondacioni për shumë vite ka pritur më kot që financime të fuqishme të premtuara të ishin derdhur faktikisht. Kjo ka shkaktuar vonesa të mëtejshme, e për pasojë, ai **ka marrë vendimin të veprojë vetë**: po punon për këtë gjë. Ky veprim i mjegullt gazetaresk duket se dëshiron të shkaktojë shqetësime me qëllim që spitali në fjalë të mos përfundojë.
- 8) Edhe pse gazetari i emisionit pohon se i ka bërë apel institucioneve të ndryshme në lidhje me spitalin, duhet bërë e ditur se për këtë çështje **nuk ka ardhur kurrë një kërkesë formale** për të takuar përgjegjësit e drejtpërdrejtë të vetë Fondacionit, në mënyrë të veçantë Presidentin që është përfaqësuesi ligjor i tij.
- 9) Përdorimi i termit “skandal” dhe “korrupsion” i përsëritur me art në emision kanë për qëllim **të ngjallin dyshime**. Emisioni është përsëritur më pas nga i njëjti kanal televiziv duke shtuar informacione të tjera të rreme, që e kanë bërë më të dukshëm pikësynimin e veprimit keqdashës.
- 10) Toni, metoda dhe përmbajtja e emisionit kanë të tjera qëllime dhe sigurisht jo atë për të dhënë informacion. Dhe **njerëzit e kanë kuptuar**. Fondacioni do të vazhdojë të çojë përpara këtë angazhim të madh për zhvillimin e Vendlindit dhe integrimin e tij, me shpirtin e solidaritetit që përherë e ka karakterizuar, duke marrë përsipër sukseset dhe mosesukseset e veta. Ai e di që njerëzit dhe institucionet, përtej përkatësisë politike, e vlerësojnë punën e tij.

Tiranë, 16 shkurt 2010

Presidenti FZKM

Atë Ruggero Valentini